



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 23 Prot.

Tiranë, më 13.01 2016

VENDIM Nr. 128, datë 22.12.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.15, të datës 22.12.2015, pasi shqyrtoi Relacionin mbi projektin "*Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, qyteti Sarandë*"- subjekti "*Ujësjellës- Kanalizime Sarandë*" Sh.A.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë projektin "*Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, qyteti Sarandë*"- subjekti "*Ujësjellës- Kanalizime Sarandë*" Sh.A., sipas përcaktimeve të mëposhtme.
- II. Subjekti "Ujësjellës- Kanalizime Sarandë" Sh.A., duhet të kontrakttojë një shoqëri të licensuar në fushën e arkeologjisë, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve në zonën "A" dhe "B" të qytetit, duke lidhur paraprakisht kontratë tre palëshe më të dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik. Ai mund të kryejë punime të zbatimit të projektit të sipërpërmendur, vetëm për zonat që kanë të bëjnë me shtrimin e linjave kryesore dhe sekondare ndërmjet rrugëve 1 dhe 4.
- III. Për zonat e tjera të zhvillimit të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, qyteti Sarandë", subjekti "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" Sh.A. duhet të depozitojë pranë ASHA dokumentacionin e plotë për sqarimin e punimeve që do të kryhen në këto zona, të cilat do të kalojnë për shqyrtim në KKA e radhës.
- IV. Subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë të depozitojë pranë DRKK Vlorë dhe ASHA, grafikun e punimeve për rrugët 1 deri 4. Në rast gjetjesh ai duhet të informojë ASHA dhe DRKK Vlorë, të realizojë procesin e dokumentimit të tyre dhe në vijim *Relacioni me rekomandimet përkatëse* të paraqitet në KKA e radhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO